



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE E EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE



RAPORTI VJETOR 2023



PËRMBAJTJA

I. Hyrja (misioni)

I.I Objektivat e AKAFPK-së	2
I.II Funksionet e AKAFPK-së	2
I.III Akronime	3

II. Veprimtaritë kryesore të AKAFPK-së 3 - 5

III. Veprimtaritë e detajuara sipas strukturës organizative

III.I Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale	6 - 11
III.II Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Ofruesve të AFP-së	11 - 17
III.III Sektori i Akreditimit të Ofruesve të AFP-së	17 - 22
III.IV Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Projekteve	22 - 26

ANEKS

Aneks 1 - Produkte që lidhen me Profesionet	27 - 28
Aneks 2 - Produkte që lidhen me Kualifikimet Profesionale	29 - 30
Aneks 3 - Produkte që lidhen me Programet Orientuese	31
Aneks 4 - Skeletkurrikula të Arsimit Profesional	32
Aneks 5 - Programe kursesh të unifikuara	33
Aneks 6 - Materiale mësimore dhe udhëzues	34 - 35

I. HYRJA (MISIONI)

AKAFPK-ja ka objekt kryesor të veprimtarisë së saj krijimin e një sistemi unik të kualifikimeve profesionale, të njohura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

I.I Objektivat e AKAFPK-së

Në përmbushje të këtij misioni, Agjencia synon të arrijë objektivat e mëposhtme:

- Zhvillimin e AFP në lidhje me nevojat e teknologjisë moderne, tregun e punës dhe zhvillimin social të vendit.
- Sigurimin e partneritetit social në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat e planifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të programeve të AFP-së.
- Integrimin e arsimit, formimit dhe punës në këndvështrimin e të nxënësve gjatë gjithë jetës.
- Zhvillimin e dimensionit evropian të AFP-së duke siguruar një transparencë të kualifikimeve dhe përafrimit të kompetencave me tregun e përbashkët evropian.
- Zhvillimin e instrumenteve për realizimin e politikave për zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
- Hartimin e instrumenteve për zbatimin e sistemit të sigurimit të cilësisë nga institucionet ofruese të AFP-së.

I.II Funkcionet e AKAFPK-së

Në përmbushje të misionit të saj, AKAFPK-ja kryen funksionet e mëposhtme:

- Harton dhe rishikon Listën Kombëtare të Profesioneve, Listën Kombëtare të Kualifikimeve Profesionale, nivelet dhe standardet përkatëse.
- Harton dhe rishikon skeletkurrikulat e kualifikimeve profesionale.
- Harton dhe rishikon standardet e trajnimit të mësimdhënësve të AFP-së.
- Përcakton parimet dhe kriteret e vlerësimit dhe certifikimit për kualifikimet profesionale.
- Akrediton institucionet e AFP për kualifikimet profesionale.
- Siguron që standardet e kompetencave të jenë në përputhje të plotë me praktikën më të mirë ndërkombëtare, në veçanti me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve dhe Sistemin Evropian të Krediteve për AFP-në.
- Siguron bashkëveprimin e të gjithë aktorëve kontribues të shoqërisë, në të gjitha nivelet dhe fazat e planifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të programeve të AFP-së.

I.III Akronime

AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
AKAFP	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
AKP	Agjencia Kombëtare e Provimeve
ETF	European Training Foundation (Fondacioni Evropian i Trajnimeve)
DRFPP	Drejtori Rajonale e Formimit Profesional Publik
ISCED në Arsim)	International Standard for Classification in Education (Standardi Ndërkombëtar për Klasifikim
ILO	International Labor Organisation (Organizata Ndërkombëtare e Punës)
IoAFP	Institucione Ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
LKP	Lista Kombëtare e Profesioneve
KEK	Korniza Evropiane e Kualifikimeve
KSHK	Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
SSHMP	Spektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Projekteve
SHKMM	Spektori i Hartimit të Kurrikulave dhe Materialeve Mbështetëse
SZHVP	Spektori i Zhvillimit të Vazhduar Profesional të Mësuesve të AFP
DPKP	Drejtorja e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale
DZHPO	Drejtorja e Zhvillimit të Programeve dhe Ofruesve të AFP-së
SA	Spektori i Akreditimit të Ofruesve të AFP-së
GVJ	Grupi i vlerësuesve të jashtëm

II. VEPRIMTARITË KRYESORE TË AKAFPK-SË

Veprimtaria e AKAFPK-së është mbështetur në Planin e punës të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm për vitin 2023 si dhe në kërkesat e nevojat e pa planifikuara. Në fokus të veprimtarive ka qenë jo vetëm përmbushja e objektivave për aspektet sasiore të produkteve të planifikuara, por edhe garantimi i cilësisë së proceseve dhe produkteve përkatëse.

Agjencia e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) ka koordinuar veprimtarinë me MFE-në dhe Agjencinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (AKPA) për të lehtësuar përdorimin e Listës Kombëtare të Profesioneve të përditësuar, miratuar me VKM nr. 514, datë 20.09.2017. Gjithashtu, është ofruar këshillim dhe orientim për të interpretuar rubrika të LKP-së sipas kërkesës së përdoruesve të ndryshëm duke lehtësuar aksesin për të gjithë përdoruesit.

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 426, datë 26.06.2019 dhe Urdhrit të përbashkët të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 163, datë 06.06.2022, “*Për ngritjen dhe përbërjen e Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit*”, ky Komitet gjatë 2023 ka filluar dhe ushtruar veprimtarinë e tij. Komiteti do të shërbejë si një mekanizëm për lidhjen e tregut të punës me ofertën e AFP-së dhe në adresimin e mungesave dhe kërkesave të aftësive nga tregu i punës drejt ofruesve të AFP-së.

Ndër arritjet dhe produktet kryesore të realizuara nga AKAFPK gjatë vitit 2023 mund të përmendim:

- Janë përshtatur 11 përshkrime profesionale, si bazë për hartimin e kurseve afatshkurta, janë hartuar 22 standarde profesionale dhe janë validuar 24 standarde profesionale. (**Aneks 1**)
- Janë zhvilluar 20 standarde kualifikimesh profesionale të niveleve 2-5 të KSHK-së dhe janë validuar 24 standarde kualifikimesh. (**Aneks 2**)
- Janë hartuar dhe rishikuar 27 Programe orientuese të kualifikimeve profesionale të niveleve 2-5 të KSHK-së dhe 6 Programe Orientuese të Maturës Shtetërore. (**Aneks 3**)
- Janë hartuar dhe rishikuar 114 Suplemente të certifikatave të kualifikimeve profesionale, si dhe është punuar për përditësimin e informacionit të kërkuar nga QSHA për plotësimin e planeve mësimore të kualifikimeve profesionale të ofruara.
- Është përgatitur Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve Profesionale dhe janë ndjekur procedura për miratim nga MFE (*33 kualifikime nga të cilat 2 janë kualifikime të reja dhe 4 kualifikime të ofruesve privat të akredituar*).
- Është përditësuar Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve Profesionale dhe është publikuar në faqen e AKAFPK-së (*gjithsej 133 kualifikime profesionale nga të cilat 4 kualifikime të ofruesve privat të akredituar*).
- Janë hartuar 3 skeletkurrikula të reja të kualifikimeve profesionale, si dhe janë rishikuar dhe përmirësuar 23 skeletkurrikula (për vitet shkollore 2023 - 2024 dhe 2024 - 2025). (**Aneks 4**)

- Janë hartuar 6 programe të reja të Kurseve të Unifikuara të FP dhe janë rishikuar 5 programe të Kurseve të Unifikuara të FP, bazuar edhe në përshkrimet apo standardet e profesioneve. **(Aneks 5)**
- Janë hartuar 20 materiale mësimore mbështetëse të lëndëve profesionale të AP dhe janë përgatitur 3 udhëzues. **(Aneks 6)**
- Në kuadër të formimit fillestar të mësimdhënësve të kulturës profesionale u realizua kursi i trajnimit “Bazat e didaktikës në AFP”, ku morën pjesë dhe u certifikuan me sukses 36 mësimdhënës nga ofrues publik të AP.
- U administrua Kualifikimi i vazhduar profesional i mësimdhënësve të kulturës profesionale në ofruesit publikë të AFP, ku morën pjesë 50 mësimdhënës, nga të cilët u certifikuan 48 mësimdhënës.
- U realizua mbështetja e ofruesve në trajnimin e përdorimit të platformës elektronike të vetëvlerësimit, si dhe finalizimi i procesit të vetëvlerësimit për 44 institucione publike dhe 1 ofrues jo publik.
- Procesi i vetëvlerësimit i zhvilluar në 44 institucione ofruese publike të AFP-së, për vitin shkollor 2021-2022, në nivel kombëtar pati vlerën 1.52.
- Në procesin e akreditimit u përfshinë 3 institucione publike dhe 1 ofrues jo publik i arsimit profesional.
- Është realizuar trajnimi dhe certifikimi i 12 specialistëve të fushës, si vlerësues të jashtëm në procesin e akreditimit të ofruesve të AFP-së.
- Në kuadër të procesit të akreditimit u organizuan pesë takime rajonale, me pjesëmarrjen e 44 IoAFP-ve, në qytetet Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Korçë.
- U hartua plani i monitorimit të ofruesve të akredituar të AFP-së, si dhe u realizua procedura e monitorimit të posaçëm për ata ofrues të AFP-së të cilëve iu dha statusi i akreditimit me kusht.
- AKAFPK ka realizuar aktivitetet dhe ka ndjekur korrespondencat zyrtare në kuadër të zbatimit të tre projekteve: EPAL NSS 2022-2024, ERASMUS-EDU-2021-AL-AGENDA-IBA dhe MoMaVET. Gjithashtu, AKAFPK-ja ka aplikuar në portalin e BE për projekte të reja dhe aktualisht ka fituar projektin ERASMUS-EDU-2023-AL-AGENDA-IBA.
- Në kuadrin e projektit MOMAVET është zhvilluar një studim për të vlerësuar gadishmërinë e shkollave profesionale për të zbatuar praktika të mobilitet të nxënësve dhe mësimdhënësve. Gjithashtu është zhvilluar një set kompetencash si bazë për zhvillimin e një programi trajnimi për manaxherët e mobilitetit në shkollat profesionale që ofrojnë kualifikime në fushën e mikëpritjes dhe turizmit.
- Në kuadër të projektit ERASMUS-EDU-2021-AL-AGENDA-IBA, Koordinator Kombëtar për Zbatimin e Agjendës së BE-së për të nxënësit e të rriturve, AKAFPK zbatoi sa vijon:
 - Hartimi i një programi për të trajnuar instruktorët se si të hartojnë strategji të mësimdhënies së kombinuar
 - Organizimi i trajnimit të trajnerëve në Tiranë (trajnim tre ditor – 2 ditë ballë për ballë dhe 1 ditë praktikë online (20 trajnerë) për strategjitë e mësimdhënies së kombinuar dhe zbatimin e tyre në mësimdhënie

- Organizimi i trajnimeve 2 ditore në 8 rajone, trajnimi i 25 instruktorëve të AFP-së për çdo rajon me aftësi të ulëta dixhitale.
- Hartimi i një udhëzuesi metodologjik për futjen e mësimit të kombinuar në fushën e të nxëniet të të rriturve.

Krahas sa më sipër, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar, AKAFPK në bashkëpunim me DAP ka vijuar me procesin e rekrutimit të stafit për plotësimin e vendeve vakante në strukturën e re. Gjatë 2023, si rrjedhojë e konkurrimit për pozicionet vakante të AKAFPK-së, në lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë apo konkurrimin nga jashtë shërbimit civil, janë plotësuar 3 pozicione, nga të cilat 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë. Institucioni do të vijojë edhe gjatë 2024 me procedurat e rekrutimit për plotësimin e 7 vendeve vakante, nga të cilat 2 përgjegjës sektori dhe 5 specialistë.

III. VEPRIMTARITË E DETAJUARA SIPAS STRUKTURËS ORGANIZATIVE

III.I DREJTORIA E PROFESIONEVE DHE KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE

Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale ka në përbërje dy sektorë përkatësisht atë të Profesioneve dhe sektorin e Kualifikimeve Profesionale. Gjatë 2023 nga të dy sektorët janë realizuar objektivat e përcaktuar në planin e punës.

III.I.I Produktet dhe veprimtaritë e realizuara

a. Zbatimi i Listës Kombëtare të Profesioneve

Është ofruar mbështetje për zbatimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP) sipas kërkesave të përdoruesve në forma të ndryshme, me konsulta të drejtpërdrejta dhe në formë elektronike.

b. Zbatimi i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)

- ✓ Zhvillimi dhe mirëmbajtja e Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale për nivelet 2-5 të KSHK në kuadër të zbatimit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
- ✓ Hulumtime të tregut të punës për sektorë të ndryshëm të ekonomisë për identifikimin e nevojave për kualifikime të reja apo rishikimin e atyre ekzistuese.
- ✓ Hartimi dhe rishikimi i standardeve të profesioneve (22 standarde profesionale) sipas nevojave të tregut të punës.
- ✓ Hartimi dhe rishikimi i standardeve të kualifikimeve (20 standarde kualifikimesh) bazuar në standardet e profesioneve.
- ✓ Validimi i standardeve të profesioneve (24 standarde të profesioneve).
- ✓ Validimi i standardeve të kualifikimeve profesionale (24 standarde të kualifikimeve).
- ✓ Janë përshtatur 11 përshkrime të profesioneve për Programe të Kurseve të Unifikuara.
- ✓ Ndjekja e një fushate informuese dhe sensibilizuese rreth procesit të referencimit të KSHK-së.
- ✓ Grumbullimi i informacioni lidhur me përgatitjen e dokumenteve të nevojshme dhe përcaktimin e procedurave për përfshirjen së kualifikimeve afatshkurtra në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.

c. Veprimtari në kuadrin e mbështetjes për vlerësimin përfundimtar dhe të vazhduar të nxënësve për kualifikime të niveleve 2-5 të KSHK

- ✓ Përmirësimi i sistemit të vlerësimit dhe certifikimit të kualifikimeve në zbatim të KSHK-së.
- ✓ Përgatitja e Programeve Orientuese të Kualifikimeve Profesionale të niveleve 2-5 të KSHK (27 programe të reja dhe të rishikuara).
- ✓ Përgatitja e Programeve Orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale (6 programe të reja dhe të rishikuara).
- ✓ Përditësimi i informacionit të kërkuar nga QSHA për plotësimin e planeve mësimore të kualifikimeve profesionale të ofruara.
- ✓ Hartimi dhe rishikimi i Suplementeve të Certifikatave Profesionale (114 të reja dhe të rishikuara).

- ✓ Studimi i ofertës së kualifikimeve në shkollat e mesme profesionale për përgatitjen e listës së nevojave për hartimin dhe rishikimin e programeve orientuese të maturës shtetërore.
- ✓ Rishikimi i Programeve Orientuese të Maturës Shtetërore për të përditësuar ndryshimet në bazën ligjore (44 PO).
- ✓ Konsulta paraprake për të propozuar zhvillimin e maturës shkollorë si një mundësi për integrim më të shpejtë në tregun e punës.

d. Mbështetje e veprimtarisë për funksionimin e Komiteteve Sektoriale (KS) të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit dhe Mikpritje dhe Turizëm

- ✓ Mbështetje për funksionimin e Komitetit Sektorial TIK për përditësimin e ofertës së kualifikimeve profesionale në sektor.
- ✓ Mbështetje për funksionimin e Komitetit Sektorial Mikpritje dhe Turizëm për përditësimin e ofertës së kualifikimeve profesionale në sektor.
- ✓ Zhvillimi i kapaciteteve të anëtarëve të Komiteteve Sektoriale për realizimin e rolit të tyre në zbatimin e KSHK-së.

e. Konsulta me ofrues të AFP dhe përfaqësues të bizneseve të ndryshëm, partnerë të këtyre shkollave

Për mbështetjen e ofruesve të Arsimit Profesional (AP) lidhur me zbatimin e KSHK dhe për efekt të monitorimit të cilësisë së programeve orientuese të prodhuar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) u realizuan një sërë takimesh me mësimdhënësit e shkollave profesionale. Takimet u zhvilluan përgjatë periudhës prill - qershor 2023. Qëllimi i këtyre vizitave ishte:

- ✓ Mbledhja e informacioneve për ecurinë e kualifikimeve profesionale dhe problematikat e hasura gjatë procesit të ofrimit të tyre.
- ✓ Identifikimi i nevojave të reja të kualifikimeve profesionale mbi bazën e kërkesave të tregut rajonal.
- ✓ Informimi i bizneseve lidhur me kualifikimet e ofruara nga shkollat profesionale, si dhe identifikimi i nevojave për kualifikime në fusha të ndryshme të aktivitetit të tyre.
- ✓ Diskutim mbi problematikat, nevojat për ndryshim të mëtejshëm, rekomandimet lidhur me programet orientuese të hartuara, cilësia e tyre dhe ndryshimet në programet e rishikuara.
- ✓ Mënyra e zbatimit të programeve orientuese, vështirësitë e hasura dhe cilësia e udhëzimeve metodike në lidhje me zbatimin e programeve orientuese.
- ✓ Identifikimi i nevojave për udhëzime apo mbështetje të mëtejshme për dokumentacionin e provimeve përfundimtare, si dhe sugjerime apo vërejtje për programet e maturës shtetërore profesionale.

Janë zhvilluar takimet në rajone të ndryshme të Shqipërisë si më poshtë:

- ✓ Shkodër: Shkolla “Arben Broci”, Shkolla pyjore “Kolë Margjini”, Shkolla “Hamdi Bushati”, Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Shkodër, Shkolla “Ndre Mjeda” (Bushat), Shkolla “Kolin Gjoka”, (Lezhë).
- ✓ Gjirokastër: Shkolla “Thoma Papapano”(Gjirokastër) dhe shkolla “Antoni Athanas” (Sarandë).

- ✓ Tiranë: Shkolla “Gjergj Canco” dhe Shkolla Teknike Ekonomike.

Nga vizitat e kryera gjatë muajve prill - qershor, rezultuan disa gjetje të cilat ishin të pranishme në pjesën më të madhe të shkollave:

- ✓ Dy vjeçarin e fundit, ka një rënie të ndjeshme të numrit të nxënësve për shkak të largimeve të rinjve jashtë Shqipërisë. Ky fenomen ka prekur shumicën e shkollave.
- ✓ Shkollat përgjithësisht kanë shumë bashkëpunime të mira me biznesin për zhvillimin e praktikës dhe për punësimin e nxënësve pas përfundimit të studimeve.
- ✓ Tezat e lëndëve profesionale me zgjedhje për maturën shtetërore nuk publikohen nga QSHA dhe kjo përbën një problem për orientimin e nxënësve para provimeve. Nuk ka asnjë model testi të maturës shtetërore për lëndët profesionale.
- ✓ Ka një interes të shtuar për kurset pas të mesmes si nga shkolla dhe nga tregu i punës.
- ✓ Rishikimi i kurrikulave, rrjedhimisht dhe i standardeve të profesioneve dhe kualifikimeve profesionale për një pjesë të drejtimeve si: Ekonomi - Biznes, Inxhinieri Informatike Softëare-ike (shkolla “Herman Gmainer”) etj., për shkak të risive që kërkon tregu në këto drejtime.

Nisur nga gjetjet që rezultuan nga takimet Agjencia vendosi të shohë mundësinë për rritjen e ofertës së kualifikimeve profesionale për arsimin pas të mesëm, niveli i V i KSHK-së sipas drejtimeve që ofrohen aktualisht në shkolla. Po kështu, Agjencia do të rishikojë të gjitha materialet përmbajtësore të hartuar në drejtimin Ekonomi - Biznes dhe Inxhinieri Informatike Softëare-ike për ti përditësuar dhe reflektuar rekomandimet e shkollës dhe bizneseve. Gjithashtu, Agjencia ka konsideruar që do të hyjë në komunikim me QSHA për mundësinë e publikimit të disa testeve të maturës shtetërore për lëndët profesionale që të shërbejnë si modele.

f. Të tjera

- ✓ Përgatitja e raportit vjetor të realizimeve të kryera për vitin 2022 dhe planit vjetor mbi objektivat e 2023 në Drejtorinë e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale.
- ✓ Takim me përfaqësues të projektit “PEMA” për të diskutuar rreth studimit të nevojave në fushën e bujqësisë për kualifikime pas të mesme (niveli V i KSHK-së).
- ✓ Pjesëmarrja në ëorkshop-in e organizuar nga OEAD në kuadër të projektit “AL-VET-cilësi për të gjithë”, “Dialogim dhe rrjetëzim me kompanitë e TIK-ut” duke diskutuar mbi përmbushjen e nevojave për aftësi profesionale në sektorin TIK dhe roli i kompanive si vend për trajnimin dhe ushtrimin e praktikës profesionale për nxënësit e drejtimit TIK.
- ✓ Pjesëmarrja në ëorkshop-et kombëtare të organizuar nga Kryeministria gjatë fazës së zhvillimit të tryezave të rrumbullakta, në kuadër të hartimit të Strategjisë së Specializimit Smart (S3).
- ✓ Pjesëmarrja në takimin raportues të grupit të menaxhimit të politikave të integruara (punësimi dhe aftësimi), organizuar nga MFE.
- ✓ Pjesëmarrje në takimin online “Rrjeti i bazave kombëtare të të dhënave” organizuar nga Fondacioni Evropian i Trajnimit, ku u trajtuan tematika dhe udhëzime për krijimin e bazave të të dhënave të kualifikimeve.
- ✓ Pjesëmarrje dhe kontribut në takimin bilateral mes Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve me Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve të Kosovës zhvilluar me mbështetjen e UNDP. Gjatë takimit u paraqitën informacione reciproke dhe këmbim

përvojash mes dy Agjencive mbi funksionimin dhe organizimin e brendshëm të tyre. Takimi u përqendrua në prezantimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (Kosovë-Shqipëri), prezantimin e procedurave të hartimit, verifikimit dhe aprovimit të standardeve të profesioneve, kualifikimeve, skeletkurikulave, diskutimin e Sigurimit të Cilësisë ku u prezantuan modelet e ndryshme të akreditimit në institucionet përkatëse.

- ✓ Pjesëmarrje dhe kontribut në takime të ndryshme të organizuar në kuadër të projektit “*Rritja e cilësisë së arsimit dhe trajnimit në SEE - EQET SEE*”, ERI SEE.
- ✓ Pjesëmarrje online në takimin e zhvilluar nga ETF lidhur me “*Better Recognition of Qualifications and Skills for Migration and Mobility*”.
- ✓ Pjesëmarrje në takimin e zhvilluar nga OAED lidhur me “*Integrimin e aspekteve gjinore në vetëvlerësim dhe gjithëpërfshirje*”.
- ✓ Pjesëmarrje në takimin e 11-të të Komitetit të Monitorimit për Programin IPARD II 2014 - 2020, organizuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
- ✓ Pjesëmarrje dhe kontribut në seminarin e planifikimit për të përcaktuar kuadrin e projektit dhe për të njëzuar strategjinë, modalitetet, financimin dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në projekt për ngritjen e qendrës së ekselencës EHL, në Tiranë organizuar nga MFE.
- ✓ Pjesëmarrje në ëorkshop-in e organizuar nga MFE me mbështetjen e projektit “*Zhvillimi i Aftësive për Punësim 2023-2027*” në kuadër të procesit të optimizimit, zhvilluar në Korçë në datat 6-7 nëntor.
- ✓ Pjesëmarrje dhe kontribut në takimin e përfaqësuesve të komiteteve sektoriale me ekspertin ndërkombëtare, në kuadër të përfshirjes së kualifikimeve afatshkurtra (nivelet 2-5) në KSHK.
- ✓ Pjesëmarrje në ëorkshop-in dy ditor me ofrues të kualifikimeve afatshkurtra, organizuar me mbështetjen e RISI Albania, lidhur me procesin e përfshirjes së kualifikimeve afatshkurtra (nivelet 2-5) në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.
- ✓ Pjesëmarrje në Konferencën e realizuar nga Expertise France me temë “*Drivers of Change for Equal Economic Development*” në kuadër të projektit “*Gender Equality in Access to Economic Opportunities*”.
- ✓ Pjesëmarrje në seminarin për konsultimin e palëve të interesuara për kornizën e aftësive bazë “*Education and Employment Promotion, GOPA Eördëide Consultants GmbH, Branch in Albania*”, mbajtur në Tirana International Hotel.
- ✓ Takim i organizuar nga ETF lidhur me vlefshmërinë/njohjen e të nxënit joformal dhe informal në Anklara të Turqisë me qëllim krijimin e një rrjeti informal midis vendeve partnere të ETF-së dhe mundësitë e të mësuarit nga njëri-tjetri në mbështetje të avancimit të mëtejshëm të sistemeve të vlefshmërisë. Vlefshmëria e të nxënit joformal dhe informal është një element i rëndësishëm i politikave të të nxënit gjatë gjithë jetës.
- ✓ Pjesëmarrje dhe kontribut në takime të tjera të fushës së AFP-së.

III.I.II Përshkrim i shkurtër i veprimitarisë së DPKP për çdo produkt

- a. Për hartimin dhe rishikimin e 22 Standardeve të profesioneve, validimin e 24 standardeve të profesioneve, 20 standardeve të Kualifikimeve profesionale, validimin e 24 standardeve të kualifikimeve, 27 programeve orientuese për nivelet e kualifikimeve dhe 6 programeve orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale janë ndërmarrë aktivitetet e mëposhtme:

- ✓ Përgatitja e njoftimit për rekrutimin e specialistëve të jashtëm, bashkëpunëtorë të AKAFPK-së për hartimin e standardeve të profesioneve, standardeve të kualifikimeve dhe programeve orientuese.
 - ✓ Konsultime dhe këshillime për identifikimin e specialistëve të tregut të punës për fushat përkatëse, si dhe sensibilizimi i tyre për të qenë pjesë e grupeve të punës pranë AKAFPK-së.
 - ✓ Përgatitja e kontratave për specialistët e jashtëm, të shpallur fitues për të qenë pjesë e grupit të punës.
 - ✓ Moderimi i takimeve të grupeve të punës për hartimin/rishikimin/validimin e standardeve të profesioneve dhe standardeve të kualifikimeve, si dhe hartimin/rishikimin e programeve orientuese.
 - ✓ Përpunimi dhe formatimi i draft-eve të përgatitura nga grupet e punës për hartimin/rishikimin/validimin e standardeve të profesioneve dhe standardeve të kualifikimeve, si dhe hartimin/rishikimin e programeve orientuese.
 - ✓ Përgatitja e dokumenteve financiare për pagesën e specialistëve të jashtëm, pjesë e grupeve të punës për hartimin/rishikimin/validimin e standardeve të profesioneve dhe standardeve të kualifikimeve, si dhe hartimin/rishikimin e programeve orientuese.
 - ✓ Publikimi i dokumenteve të hartuar dhe rishikuar, në faqen zyrtare të AKAFPK-së.
- b. Është përgatitur Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve Profesionale dhe janë ndjekur procedura për miratim nga MFE (*33 kualifikime nga të cilat 2 janë kualifikime të reja dhe 4 kualifikime të ofruesve privat të akredituar*).
- c. Është përditësuar Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve Profesionale dhe është publikuar në faqen e AKAFPK-së (*gjithsej 133 kualifikime profesionale nga të cilat 4 kualifikime të ofruesve privat të akredituar*).
- d. Në bashkëpunim me një eksperte ndërkombëtare ka filluar puna për përgatitjen e dokumenteve të nevojshme dhe përcaktimin e procedurave për përfshirjen e kualifikimeve afatshkurtra në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (takime me ekspertë ndërkombëtarë), si dhe është filluar një fushatë ndërgjegjësuese me ofruesit e këtyre kualifikimeve.
- e. Janë përgatitur rekomandime për ndryshimin e Udhëzimit nr. 16/2019, datë 26.04.2019, “*Llojet, procedurat dhe mënyrat për lëshimin e certifikatave, si dhe formatet që do të përdoren në sistemin e AKAFPK-së*”, janë përgatitur modelet e certifikatave, dëftesave dhe suplementeve dhe është ndjekur procedura për miratim nga MFE.
- f. Janë hartuar 6 Programe Orientuese të reja dhe janë rishikuar 27 PO të niveleve të ndryshme dhe të Maturës Shtetërore Profesionale.
- g. Është përgatitur dhe dërguar në QSHA tabela për lëndët dhe modulet e AFP për të gjitha drejtimet dhe profilet.
- h. Janë hartuar dhe rishikuar 114 suplemente të certifikatave të niveleve II, III, IV dhe V të KSHK-së:
- ✓ 20 Niveli II
 - ✓ 55 niveli III
 - ✓ 16 niveli IV
 - ✓ 17 niveli IV
 - ✓ 4 niveli IV
 - ✓ 2 niveli V

i. Komitetit Sektorial “Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit” (TIK):

- ✓ Anëtarë të Komitetit Sektorial TIK dhe sekretariati teknik i KS zhvilluan një vizitën studimore në Estoni në kuadër të ngritjes së kapaciteteve, mbështetur nga RISI Albania.
- ✓ Është përgatitur informacioni i kërkuar nga Komiteti Sektorial lidhur me gjendjen aktuale të TIK në shkollat profesionale, informacion për kurset afatshkurtra të ofruara në Qendrat e Formimit Profesional Publik, si dhe është përgatitur informacioni lidhur me ofertën e kualifikimit “Informatikë Ekonomike” (kërkesë e bërë nga AKPA), e cila i është paraqitur anëtarëve të KS për diskutim.
- ✓ Janë organizuar dhe zhvilluar takimet e KS për vitin 2023.
- ✓ Gjatë takimeve janë validuar standardet e profesioneve “*Teknik të inxhinierisë softëare-ike*” (shkolla “Hermann Gmeiner”), niveli IV në KSHK dhe “*Specialist i sigurisë kibernetike*”, niveli V në KSHK.
- ✓ Janë përgatitur minutat e takimeve përkatëse të KS TIK dhe janë publikuar në ëbsite e AKAFPK-së.

j. Komiteti Sektorial i Mikpritjes dhe Turizmit

- ✓ AKAFPK në bashkëpunim me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) organizoi takimin e parë prezantues të Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit. Në këtë takim anëtarët u njohën me funksionet dhe detyrat e Komitetit Sektorial, funksionet e AKAFPK-së, diskutuan mbi pritshmëritë e tyre për këtë Komitet, si dhe zgjodhën kryetarin e KS, z. Rrahman Kasa, drejtues i Unionit Turistik Shqiptar.
- ✓ Gjatë takimeve vijuese, janë diskutuar propozimet e anëtarëve për profile të reja në drejtimin e hoteleri - turizmit, është bërë prezantimi i metodologjisë për Studimin e Nevojave të Aftësive (SNA) në fushën e mikpritjes dhe turizmit. Në këtë kuadër, anëtarëve të KS u është shpërndarë një pyetësor për komente dhe sugjerime.
- ✓ Janë organizuar dhe zhvilluar takimet e KS për vitin 2023.
- ✓ Është validuar standardi i profesionit “*Kuzhinier*” dhe standardi i kualifikimit “*Kuzhinë - Pastiçeri*”, niveli III në KSHK.
- ✓ Janë përgatitur minutat e takimeve të KS për Mikpritje dhe Turizëm dhe janë publikuar në ëbsite e AKAFPK-së.

III.II DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE DHE OFRUESVE TË AFP-SË

Drejtoria e ZHPO ka në përbërje dy sektorë, atë të Hartimit të Kurrikulave dhe Materialeve Mbështetëse (HKMM) dhe Sektorin e Zhvillimit të Vazhduar Profesional të Mësuesve të AFP (ZHVP). Objektivat vjetore të planifikuara ose të rishikuara janë përmbushur falë punës dhe bashkëpunimit me gjithë palët e përfshira në proces.

III.II.I Veprimtaria dhe kontributet e Sektorit të HKMM

Në zbatim të funksioneve dhe në plotësim të detyrave, Sektori i HKMM, gjatë vitit 2023, ka kontribuar nëpërmjet kryerjes së një tërësie procesesh dhe realizimit të disa produkteve kryesore që kanë mbështetur zhvillimin e AFP si në nivel qendror, ashtu edhe në nivelin e ofruesve publikë

të AFP-së. Më poshtë renditen kontributet kryesore të këtij sektori, të ndara sipas fushave të veprimtarisë.

a) Hartimi dhe rishikimi i dokumentacionit kurrikular për AFP dhe mbështetja e zbatimit të tij

Përgatitja e dokumentacionit kurrikular (skeletkurrikula, programe kursesh të unifikuara, materiale mësimore mbështetëse, programe lëndore, module profesionale, programe shkollore të periudhës para vitit 2008, dokumentacion transferimesh të nxënësve) përbën vëllimin më të madh të punës së sektorit të HKMM edhe gjatë vitit 2023. Moderimi i hartimit të dokumentacionit të ri kurrikular është bërë në përputhje me metodologjinë dhe formatet e miratuara dhe në zbatim të Udhëzimit të MFE, nr. 27, datë 30.07.2018, “Për formatet dhe procedurat kurrikulare të AFP”. Përcaktimi dhe përgatitja e dokumenteve kurrikulare janë mbështetur në analizat e kryera dhe informacionet e marra nga zbatuesit e tyre, si dhe në dokumentet përkatëse të përgatitura nga Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale (lista e profesioneve, standardet e profesioneve dhe standardet e kualifikimeve). Garanci për cilësinë e këtyre produkteve ka qenë angazhimi i drejtpërdrejtë dhe përvoja e shumë bashkëpunëtorëve dhe grupeve të punës me specialistë të AFP, si dhe të biznesit, të përzgjedhur me kujdes nëpërmjet procedurave zyrtare të AKAFPK.

Bazuar në të dhënat e mbledhura për gjendjen e kurrikulave, si dhe në ndryshimet e standardeve të kualifikimeve përkatëse, gjatë vitit 2023, Sektori i HKMM ka koordinuar dhe moderuar procesin e hartimit të 3 skeletkurrikulave të reja të kualifikimeve profesionale si dhe të rishikimit e përmirësimit të 23 skeletkurrikulave (për vitet shkollore 2023 - 2024 dhe 2024 - 2025). Përsa i përket programeve të kurseve të formimit profesional, u moderua hartimi i 6 programeve të reja të Kurseve të Unifikuara të FP dhe rishikimi i 5 programeve të Kurseve të Unifikuara të FP, bazuar edhe në përshkrimet apo standardet e profesioneve.

Për të mbështetur mësuesit e lëndëve profesionale dhe nxënësit në AP, duke konsideruar që në AP ka mungesa të theksuara të teksteve mësimore, Sektori i HKMM ka analizuar gjendjen, ka përcaktuar nevojat më prioritare dhe ka moderuar procesin e hartimit të 20 materialeve mësimore mbështetëse të lëndëve profesionale të AP. Në zbatim të Urdhërit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr. 115, datë 18.05.2020, “Për trajtimin e kërkesave të personave për pajisje me programet mësimore lëndore të zbatuara në institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë në Republikën e Shqipërisë para vitit shkollor 2008 - 2009”, Sektori i HKMM gjatë vitit 2023 ka gjeneruar programet sintetike të zbatuara në shkollat profesionale para vitit 2008 dhe ka plotësuar kërkesat për 108 aplikues, për programe të tilla. Gjatë vitit 2023, Sektori i HKMM ka kryer edhe procedurat e duhura për transferimin e 8 nxënësve, nga shkollat profesionale jashtë vendit, në shkollat profesionale të vendit tonë.

b) Monitorime për zbatimin e kurrikulave qendrore dhe për ecurinë e funksionimit të Njërive të Zhvillimit në ofruesit e AFP

Specialistët e Sektorit të HKMM kanë mbikëqyrur dhe kanë marrë informacione për ecurinë e zbatimit të Skeletkurrikulave të AP dhe Programeve të Kurseve të Unifikuara të FP, si dhe nevojave për materiale mësimore, nëpërmjet vizitave, takimeve të drejtpërdrejta dhe takimeve

online me drejtues, mësues dhe instruktorë në shumicën e shkollave profesionale dhe DRFPP-ve të vendit.

Tematika e monitorimeve është e fokusuar te:

- vështirësitë dhe problematikat në përmbajtjen dhe zbatimin e dokumentacionit kurrikular;
- zbërthimi në nivel ofruesi të dokumentacionit kurrikular;
- llojshmëria dhe përshtatshmëria e materialeve mësimore mbështetëse.

Për të përmbushur kërkesat e monitorimit, janë kryer vizita dhe mbledhje informacioni në 27 shkolla profesionale publike të Tiranës, Rubikut, Peshkopisë, Kukësit, Lezhës, Durrësit, Golemit, Kavajës, Elbasanit, Cërrikut, Korçës, Lushnjës, Beratit, Fierit, Vlorës, Sarandës dhe Gjirokastrës, si dhe në 6 qendra të formimit profesional publik të Durrësit, Elbasanit, Korçës, Fierit, Vlorës dhe Gjirokastrës.

Gjatë vizitave dhe takimeve të drejtpërdrejta janë shkëmbyer informacione me vlerë për aspektet kurrikulare si dhe janë dhënë sqarime dhe udhëzime për drejtuesit, koordinatorët e kurrikulave dhe mësimeve.

III.II.II Veprimtaria dhe kontributet e Sektorit të ZHVP

Gjatë vitit 2023, Sektori i ZHVP, në zbatim të neneve 61, 62, 63 të Udhëzimit të MFE nr. 14, datë 27.05.2021 “*Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të AFP, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të AFP dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit*”, si dhe të Udhëzimit të MFE nr. 21, datë 27.06.2022, “*Për kualifikimin e vazhduar profesional të mësimeve të kulturës profesionale në AFP*”, e ka fokusuar veprimtarinë në tre drejtime kryesore:

a) Formimi fillestar i mësimeve të kulturës profesionale në ofruesit publikë të AFP

Gjatë vitit 2023, Sektori i ZHVP ka koordinuar dhe harmonizuar zbatimin e Kursit të trajnimit 30 ditor “*Bazat e didaktikës në AFP*”, për të gjithë mësimeve fillestarë të kulturës profesionale, të emëruar (me kontratë të përkohshme) në ofruesit e AP, gjatë vitit shkollor 2022 - 2023. U konceptuan procedurat dhe u krijua baza elektronike e të dhënave që lidhet me gjithë procedurën e ofrimit të këtij kursi trajnimi. Kursi i trajnimit u realizua kryesisht në formatin me prezencë fizike në mjediset e Shkollës Teknike Ekonomike të Tiranës dhe një pjesë në formatin online. Në kurs u angazhuan 15 trajnerë me përvojë, të cilët aplikuan online dhe u përzgjedhën nga Komisioni i Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve të jashtëm, me kontratë. Në kurs morën pjesë 42 mësimeve të rinj dhe u certifikuan me sukses 36 mësimeve nga ofrues publik të AFP të Tiranës, Elbasanit, Durrësit, Shkodrës, Lushnjës, Vlorës, Beratit, Lezhës, Kavajës dhe Korçës.

Sektori i ZHVP, për ofrimin e kursit të trajnimit “*Bazat e didaktikës në AFP*”, ka kryer veprimtaritë e mëposhtme:

- Përgatitja e dokumentacionit zyrtar të ofrimit të kursit të trajnimit “*Bazat e didaktikës në AFP*”, për vitin 2023 (shkresa të ndryshme, urdhëra, njoftime për pjesëmarrësit dhe bashkëpunëtorët, përzgjedhja e bashkëpunëtorëve, kontratat për bashkëpunëtorët, dokumentacioni për pagesat e bashkëpunëtorëve etj.).

- Krijimi i regjistrimit elektronik me të dhënat e mësimdhënësve potencialë për ndjekjen e kursit të trajnimit.
- Përgatitja e materialeve të trajnimit të mësimdhënësve mbi “*Bazat e didaktikës në AFP*” (agjendat modulet, materialet mbështetëse, detyrat, materialet për vlerësimin, listë prezencat, certifikatat etj.).
- Koordinimi i trajnerëve dhe harmonizimi i programit të kursit 30 ditor për “*Bazat e didaktikës në AFP*”.

Realizimi i këtij funksioni ka krijuar një përvojë me vlerë për ecurinë e mëtejshme në vitet në vijim.

b) Kualifikimi i vazhduar (atestimi) i mësimdhënësve të kulturës profesionale në ofruesit publikë të AFP

Gjatë vitit 2023, Sektori i ZHVP u angazhua për të administruar procedurën e Kualifikimit të vazhduar profesional të mësimdhënësve të kulturës profesionale në ofruesit publikë të AFP, bazuar edhe në përvojën e fituar gjatë vitit 2022. Në këtë proces fituan të drejtën për t’iu nënshtruar provimit të kualifikimit 50 mësimdhënës nga ofrues publik të AFP-së. Në përfundim të procesit të kualifikimit të vazhduar profesional të mësimdhënësve, u certifikuan 48 prej tyre, sipas kategorisë përkatëse të kualifikimit: 34 kandidatë për kategorinë “Mësues të kualifikuar” (5 vjeçar); 11 kandidatë për kategorinë “Mësues specialistë” (10 vjeçar) dhe 3 kandidatë për kategorinë “Mësues mjeshtrë” (20 vjeçar). Dy mësimdhënës që ndoqën procesin, nuk u kualifikuan. Lidhur me këtë proces janë kryer veprimtaritë e mëposhtme:

- Krijimi i Komisionit të Kualifikimit të Mësimdhënësve të AFP-së për vitin 2023.
- Përgatitja e dokumentacionit zyrtar të duhur për zbatimin e procedurës së kualifikimit të vazhduar profesional të mësimdhënësve të kulturës profesionale në ofruesit e AFP, për vitin 2023 (udhëzuesa, urdhëra, shkresa të ndryshme, njoftime për bashkëpunëtorët, përzgjedhja e bashkëpunëtorëve, kontratat për bashkëpunëtorët, dokumentacioni për pagesat e bashkëpunëtorëve etj.).
- Krijimi i regjistrimit elektronik me të dhënat e mësimdhënësve kandidatë për kualifikim, sipas kategorive të kualifikimit.
- Pranimi, shqyrtimi i dokumentacionit të kërkuar, vlerësimi paraprak me pikë, pranimi i ankimeve, vlerësimi përfundimtar i 50 protofoleve dhe njoftimi për pikët e fituara i mësimdhënësve kandidatë.
- Mbikëqyrja e procesit të hartimit të njësive të testit për dy provimet e kualifikimit (sipas grupeve “A” dhe “B”) të mësimdhënësve.
- Organizimi, monitorimi dhe administrimi i procesit të provimeve të kualifikimit të dy grupeve, “A” dhe “B”.
- Vlerësimi me pikë i rezultateve të 49 testeve të provimit të kualifikimit, pranimi dhe shqyrtimi i ankesave, njoftimi për rezultatet/pikët përfundimtare të fituara në provimet e kualifikimit.
- Llogaritja e rezultatit të kualifikimit të arritur (portofol dhe provim), pranimi, shqyrtimi i ankesave dhe njoftimi i kandidatëve për rezultatet/pikët përfundimtare të kualifikimit dhe shkallën e fituar.

- Konceptimi, printimi dhe dërgimi i certifikatave për 48 mësimdhënësit që kaluan me sukses këtë proces kualifikimi, në përputhje me kategorinë e kualifikimit përkatës.

Tashmë Sektori i ZHVP ka krijuar një paketë dokumentesh, një databazë elektronike të dhënash, një rrjet bashkëpunëtorësh dhe përvojë pozitive, si bazë për vijimin me sukses të këtij funksioni edhe në të ardhmen.

c) Mbështetja e Njësive të Zhvillimit të ofruesve publikë të AFP

Gjatë vitit 2023, Sektori i ZHVP ka trajnuar, udhëzuar e këshilluar koordinatorët e Njësive të Zhvillimit (NjZh), si dhe drejtuesit e ofruesve të AFP-së, në lidhje me përmbushjen e rolit që kanë. Kjo mbështetje është kryer si nëpërmjet kontakteve dhe takimeve të drejtpërdrejta (gjatë takimeve në AKAFPK dhe vizitave monitoruese në 27 shkolla profesionale publike dhe 6 DRFPP), ashtu edhe nëpërmjet veprimtarive të veçanta e komunikimeve në distancë (e-mail, biseda telefonike, ëëbinare). Sektori përgatiti një raport për monitorimin e realizuar në Njësitë e Zhvillimit.

Përsa i përket mbështetjes së mësimdhënësve të AFP për aspektet didaktike, Sektori i ZHVP, në takimet, bashkëbisedimet dhe vëzhgimet e kryera në shkollat profesionale dhe DRFPP-të, ka marrë të dhëna për gjendjen dhe nevojat e mësimdhënësve dhe ka ofruar mbështetjen për ta.

Janë zhvilluar seanca të trajnimit (me prezencë fizike dhe online), si më poshtë:

- Trajnimi 6-ditor për 15 Koordinatorë të Marrëdhënieve me Biznesin (mbështetur nga OeAD).
- Trajnimi 6-ditor për 40 Koordinatorë të Sigurimit të Cilësisë (mbështetur nga OeAD).
- Trajnimi 3-ditor për rreth 40 Koordinatorë për hartimin dhe zbatimin e projekteve zhvillimore në nivel ofruesi të AFP (mbështetur nga S4J).
- Trajnimi 3-ditor për rreth 40 Koordinatorë për zhvillimin e marketingut të ofruesit të AFP (mbështetur nga S4J).
- Trajnimi 3-ditor për rreth 40 Koordinatorë për kryerjen e gjurmimit në nivel ofruesi (mbështetur nga S4J).
- Disa takime me Koordinatorë të Marrëdhënieve me Biznesin dhe Koordinatorë të Sigurimit të Cilësisë për përmirësimin e kriterëve të cilësisë në marrëdhëniet shkollë - biznes dhe aspekte të tjera të veprimtarisë së tyre (mbështetur nga OeAD).

Në kuadër të fillimit të vitit shkollor 2023 - 2024, Sektori i ZHVP-së kontribuoi në përgatitjen dhe publikimin e një “Udhëzuesi për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale” me informacione mjaft të dobishme për aspektet kurrikulare, të mësimdhënies, të vlerësimit të nxënësve, të zbatimit të procedurave të ZHVP-së, mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP (kualifikimit fillestar, kualifikimi i vazhduar, mbështetja e NjZh), të organizimit të orarit të shkollave, të orientimit të tyre nga kërkesat e tregut rajonal të punës etj.

III.II.III Veprimtari në kuadrin e bashkëpunimeve

Një pjesë e ndjeshme e kohës së punës së Drejtorisë së ZHPO i është kushtuar veprimtarive të ndryshme në kuadrin e porosive të Ministrisë përgjegjëse për AFP (MFE) dhe të bashkëpunimeve të kryera me institucione kombëtare dhe aktorë të tjerë, me projektet e donatorëve dhe institucionet

e ndryshme ndërkombëtare që janë partnerë të rëndësishëm në zhvillimin e AFP në Shqipëri. Të tilla veprimtari janë:

- Pjesëmarrje në procesin e rishikimit të kuadrit ligjor të AFP, hartimit të draft-eve të akteve nënligjore të AFP (kryesisht për Udhëzimin e MFE, nr. 21, datë 27.06.2022, “*Për kualifikimin e vazhduar profesional të mësimitdhënësve të kulturës profesionale në AFP*”).
- Pjesëmarrje në Komitetin e Maturës Shtetërore, komente për aktet nënligjore të lidhura me Maturën Shtetërore Profesionale (udhëzimet dhe rregulloret).
- Pjesëmarrje në takime për diskutimin, si dhe komentimi i dokumenteve të ndryshme të Drejtorisë apo të njësisve të tjera të AKAFPK, në kuadrin e bashkëpunimit të brendshëm të AKAFPK-së.
- Pjesëmarrje në Komisionin e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve, anëtarë të grupeve të punës, për produktet e AKAFPK-së.
- Pjesëmarrje në Komisionin e Kualifikimit të Mësimitdhënësve të AFP-së.
- Pjesëmarrje në Komisionin e transferimit të nxënësve në AP.
- Pjesëmarrje në takimet e Komiteteve Sektoriale.
- Përgatitja e planit të buxhetit të Drejtorisë së ZHPO, si dhe ndryshimet eventuale gjatë vitit.
- Komente për Urdhërin për fillimin e vitit shkollor 2023 - 2024 (kërkesë nga MAS).
- Takime në MFE për aspekte të ndryshme të AFP-së.
- Pjesëmarrje në Programin Rajonal (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut) “*Shkolla takon Biznesin*”, mbështetur nga OeAD.
- Pjesëmarrje dhe prezantime në Takimet dhe Trajnimet për “*Shkolla takon Biznesin*”, organizuar në Tiranë ose online (OeAD).
- Takime dhe kontribute në kuadrin e veprimtarive të projektit S4J për materialet mësimore digjitale dhe aspekte të tjera.
- Takime dhe kontribute në kuadrin e veprimtarive të projektit “*PEMA*” për shkollat bujqësore.
- Pjesëmarrje në takimet dhe ëbinare-t online për aspekte të ndryshme të AFP-së, organizuar nga S4J, UNDP, OeAD, GIZ, PEMA, EPALE, ETF, ILO, Junior Achievement, Save the Children etj.

III.II.IV Veprimtari të tjera

Drejtoria e ZHPO, gjatë vitit 2023 ka kryer edhe veprimtari të tjera që lidhen me:

- Përgatitjen e dokumentacionit zyrtar që ka të bëjë me veprimtarinë dhe produktet (raporte javore, periodike dhe vjetore, plane periodike dhe vjetore, listë-prezenca të stafit, shkresa të ndryshme, njoftime për bashkëpunëtorët, përzgjedhja e bashkëpunëtorëve, kontratat për bashkëpunëtorët, dokumentacioni për pagesat e bashkëpunëtorëve, planifikimi i buxhetit të drejtorisë, dokumentacioni financiar, vlerësimi i stafit, materialet për publikime në faqe interneti etj.).

- Përgatitjen e analizave, komenteve, raportimeve, opinioneve etj., për aspekte të ndryshme të AFP-së.
- Kontribute në rifreskimin me informacione të faqes së internetit të AKAFPK-së.
- Trajnimin dhe vet-trajnimin e vazhdueshëm të stafit. Kjo është kryer nëpërmjet studimit individual, shkëmbimit të përvojës, pjesëmarrjes në veprimtari trajnimi të drejtpërdrejta ose online, kryesisht të ofruara nga ASPA dhe donatorët, ndjekjes së kualifikimeve formale etj.

III.III SEKTORI I AKREDITIMIT TË OFRUESVE TË AFP-SË

Përgjatë vitit 2023, Sektori i Akreditimit të ofruesve të AFP-së, për realizimin e veprimtarive të planifikuara në fushën e Sigurimit të Cilësisë, është mbështetur në objektivat vjetore të kësaj njësie organizative, si dhe në objektivat specifik për çdo punonjës. Puna e këtij Sektori është fokusuar në dy procese kryesore të Sigurimit të Cilësisë:

- I. Procesi i vetëvlerësimit të IoAFP-ve
- II. Procesi i Akreditimit të IoAFP-ve

III.III.I Zhvillimi i Procesit të vetëvlerësimit të IoAFP-ve

a) Mbështetja dhe monitorimi i IoAFP-ve për realizimin e procesit të vetëvlerësimit

Në kuadër të bashkëpunimit me UNDP-në, Programi “Zhvillimi i Aftësive për Punësim” dhe me mbështetjen e MFE, gjatë këtij viti i gjithë procesi i vetëvlerësimit të ofruesve të AFP-së, u zhvillua sipas një kalendari të miratuar nga AKAFPK-ja, për të gjitha hapat e procesit dhe u realizua mbështetja e ofruesve në trajnimin e përdorimit të platformës elektronike të vetëvlerësimit, si dhe finalizimi i procesit të vetëvlerësimit për 44 institucione publike dhe 1 ofrues jo publik.

Ky proces u finalizua me dorëzimin e raporteve finale të vetëvlerësimit nga të gjithë ofruesit e AFP-së, 44 institucione publike dhe 1 ofrues jo publik, përfshirë kontrollin e "gatishmërisë për akreditim".

b) Organizimi i takimeve rajonale në kuadër të procesit të vetëvlerësimit

Në kuadër të procesit të vetëvlerësimit, si një proces i rëndësishëm në zhvillimin e brendshëm të cilësisë në institucionet ofruese të AFP-së dhe komunikimit/shpërndarjes së informacionit me grupet e interesit për nisjen e procesit të akreditimit, u organizuan pesë takime rajonale në qytetet Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Korçë. Në këto takime rajonale u diskutua në lidhje me ecurinë e procesit të vetëvlerësimit si dhe informimi për hapat dhe procedurat e mëtejshme të nisjes së procesit të akreditimit.

Me përfundimin e periudhës së vetëvlerësimit për vitin shkollor 2022 - 2023 dhe marrjen e të gjithë raporteve, nisi puna me një analizë të detajuar të çdo raporti, duke parë dhe përdorimin e

instrumentit të përmirësimit të cilësisë dhe hartimin e planit të përmirësimit, si dhe përfshirja e këtij instrumenti në procesin e vetëvlerësimit.

Në vijim, gjatë vitit shkollor 2023 - 2024 procesi i vetëvlerësimit po kryhet për vitin shkollor 2022 - 2023, mbështetur në udhëzimin nr. 18, datë 06.07.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 16, datë 08.05.2018, “Për zhvillimin e vetëvlerësimit në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional””, ku të gjithë IoAFP-të do të vlerësojnë pesë fushat e cilësisë. Për këtë, është hartuar dhe shpërndarë kalendari i zbatimit të procesit të vetëvlerësimit në institucionet ofruese të AFP-së, me afatet e zhvillimit të procesit të vetëvlerësimit, për ti shërbyer procesit të akreditimit, si hapi i parë i këtij procesi kaq të rëndësishëm të sigurimit të cilësisë, proces i cili finalizohet më datë 31 janar 2024.

Gjatë muajit tetor 2023, me mbështetjen e UNDP-së u ndërtua një pyetësor për identifikimin e nevojave dhe pikave të forta të procesit të vetëvlerësimit. Mbështetur në rezultatet e këtij pyetësori, Sektori i akreditimit organizoi punën në vijim për mbështetjen dhe monitorimin e IoAFP-ve për procesin e vetëvlerësimit edhe për këtë vit shkollor. Në bazë të një plani të miratuar të monitorimit dhe mbështetjes të procesit të vetëvlerësimit, duke respektuar afatet e Kalendarit të zhvillimit të procesit të vetëvlerësimit, u vizituan të gjithë institucionet ofruese të AFP-së. Gjatë takimeve individuale në çdo IoAFP u diskutua dhe asistua mbi problematikat e hasura gjatë përdorimit të platformës digjitale *scvet.al* dhe nevojat individuale të konstatuara nga pyetësori.

c) Analiza e raporteve individuale të IoAFP-ve dhe përgatitja e raportit përmbledhës të rezultateve të vetëvlerësimit në nivel kombëtar 2021 - 2022

Mbështetur në Udhëzimin nr. 18, datë 06.07.2018, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 16, datë 08.05.2018, “Për zhvillimin e vetëvlerësimit në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional”, ofruesit publikë të AFP-së kanë zbatuar procesin e vetëvlerësimit sipas një kalendari të miratuar nga AKAFPK, kanë mbledhur të dhënat dhe kanë hartuar raportin përfundimtar të vetëvlerësimit.

Në përfundim të procesit të vetëvlerësimit për vitin shkollor 2021 - 2022, u mblodhën të gjitha raportet e dërguara nga ofruesit e AFP-së, të cilat u analizuan nga sektori i akreditimit të ofruesve të AFP-së, gjatë periudhës qershor - dhjetor 2023, për të përgatitur raportin përmbledhës për rezultatet e vetëvlerësimit në nivel kombëtar.

Zbatimi i procesit të vetëvlerësimit për vitin shkollor 2021 - 2022 tashmë ishte në vitin e pestë, i cili dëshmoi për një rritje të ndërgjegjësimit të ofruesve të AFP-së, për rolin e procesit të vetëvlerësimit në sigurimin e brendshëm të cilësisë.

Zbatimi i procesit të vetëvlerësimit në 44 institucione ofruese publike të AFP-së, ka evidentuar aspektet pozitive dhe ato problematike, në pesë fushat e cilësisë dhe rezultatet e procesit të vetëvlerësimit janë mbajtur në konsideratë për hartimin e raportit kombëtar të vetëvlerësimit. Problematikë e konstatuar që vlen për tu përmendur është se ka ende punë që duhet bërë në lidhje

me përvetësimin e plotë të instrumentit të përmirësimit të cilësisë, konsolidimit të planit të përmirësimit të cilësisë si dhe rritjen e efikasitetit të administrimit në tërësi të procesit të Vetëvlerësimit.

Për periudhën në të cilën u zhvillua procesi i vetëvlerësimit, për vitin shkollor 2021 - 2022, në nivel kombëtar pati vlerën 1.52.

III.III.II Zhvillimi i Procesit të Akreditimit

AKAFPK-ja, në bashkëpunim me UNDP-në, Programi “Zhvillimi i Aftësive për Punësim” në mbështetje të Urdhrit nr. 128, datë 06.07.2021 “*Për miratimin e rregullores për standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional*” të MFE-së, ka zhvilluar veprimtari dhe dokumente të tjera si:

- Rishikimi i procedurave të brendshme për procesin e akreditimit, të finalizuar me Urdhrin nr. 23, datë 12.05.2023.
- Hartimi i procedurave, dokumenteve dhe formularëve të standardizuar në mbështetje të procesit të akreditimit.
- Hartimi dhe përshtatja e pyetësorëve për nxënësit, mësimdhënësit, bizneset, prindërit.
- Hartimi i matricës për zbatimin e procedurës së monitorimit të institucioneve të akredituara.
- Mirëmbajtja dhe përditësimi i regjistrit kombëtar të certifikatave të akreditimit.
- Mirëmbajtja dhe përditësimi i informacionit në faqen zyrtare të AKAFPK-së për proceset e Sigurimit të Cilësisë.

Pas një pune voluminoze të realizimit të modelit të parë të procesit të akreditimit, me standardet, procedurat, instrumentet dhe udhëzimet e zbatimit të procesit, nisi zbatimi i procesit të akreditimit edhe përgjatë vitit 2023. Bazuar në Urdhrin nr. 128, datë 06.07.2021 “*Për miratimin e rregullores për standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional*” të MFE-së, u realizua procesi i akreditimit, bazuar në gatishmërinë e ofruesve për akreditim, ku u përfshinë 3 institucione publike dhe 1 ofrues jo publik i arsimit profesional, për kualifikime profesionale të ofertës së tyre arsimore.

Institucionet e përfshira në këtë proces dhe numri i kualifikimeve përkatëse janë si më poshtë:

1. Shkolla e Mesme Teknologjike “Hysen Çela”, Durrës ⇒ 11 kualifikime profesionale sipas KSHK-së.
2. Shkolla e Mesme Profesionale “Beqir Çela”, Durrës ⇒ 4 kualifikime profesionale sipas KSHK-së.
3. Shkolla e Mesme Profesionale “Charles Telford Erickson”, Tiranë ⇒ 6 kualifikime profesionale sipas KSHK-së.
4. Shkolla e Mesme Profesionale “Shën Jozefi Puntor”, Rrëshen ⇒ 18 kualifikime profesionale sipas KSHK-së.

Grupet e vlerësuesve të jashtëm për çdo IoAFP, mbështetur edhe nga koordinatorët e këtij procesi, arritën të finalizojnë dhe të dorëzojnë raportet përfundimtare të Akreditimit, të cilat u përcollën në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, sipas procedurës së miratuar.

a) Zhvillimi i mëtejshëm i burimeve njerëzore për vlerësuesit e jashtëm të procesit të akreditimit

AKAFPK, në vijim të zhvillimit të mëtejshëm të burimeve njerëzore, ka përzgjedhur një listë me specialistë të fushës, për t'u trajnuar dhe certifikuar si vlerësues të jashtëm në procesin e akreditimit të ofruesve të AFP-së.

Ky proces u fokusua më së shumti në rekrutimin, përzgjedhjen dhe trajnimin e vlerësuesve të jashtëm dhe trajnimin e ekspertëve të brendshëm të AKAFPK-së. Programi i trajnimit u zhvillua për grupin e tretë të 14 kandidatëve të tjerë për vlerësues të jashtëm të IoAFP-ve, nga të cilët u pajisën me certifikatë 12 vlerësues të jashtëm për akreditimin e ofruesve të arsimit dhe formimit profesional. Ky grup përfundoi dhe bllokun e dytë të trajnimit (pjesa praktike) gjatë periudhës janar - shkurt 2023, në total pati 10 ditë/60 orë trajnimi (36 orë teori dhe 24 orë praktikë) dhe me certifikimin e grupit të tretë, në total certifikohen 50 kandidatë si vlerësues të jashtëm të procesit të akreditimit dhe specialistët e AKAFPK-së.

b) Informim në lidhje me procesin e akreditimit

Në kuadër të informimit të grupeve të interesit për nisjen e procesit të akreditimit janë zhvilluar një sërë veprimtarish si më poshtë:

➤ ***Takime rajonale***

Në kuadër të procesit të komunikimit/shpërndarjes së informacionit me grupet e interesit për nisjen e procesit të akreditimit, u organizuan pesë takime rajonale, me pjesëmarrjen e 44 IoAFP-ve, në qytetet Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Korçë. Në këto takime rajonale u diskutua në lidhje me ecurinë dhe rëndësinë e procesit të vetëvlerësimit si hapi i parë i procesit të akreditimit, si dhe u realizua informimi për hapat dhe procedurat e mëtejshme të nisjes së procesit të akreditimit.

➤ ***Marketing dhe komunikim me grupet e interesit për procesin e akreditimit***

Me fokus promovimin dhe komunikimin me grupet e interesit për procesin e akreditimit, u zhvillua një video promovuese, në bashkëpunim me UNDP-në, Programi “Zhvillimi i Aftësive për Punësim”. Gjithashtu, procesi i akreditimit është prezantuar dhe në emisionin “Auditor arsimit” në RTSH.

c) Monitorimi i IoAFP-ve në të cilat është pilotuar procesi i akreditimit

Sektori i akreditimit të ofruesve të AFP-së, zhvilloi një model të konceptit të Planit të monitorimit për secilin tip monitorimi dhe metodologjinë përkatëse të zbatimit të tij.

Në këtë kuadër hartuam planin e monitorimit të ofruesve të akredituar të AFP-së duke përfshirë llojet, format dhe instrumentet e monitorimit i cili u miratua me shkresë nr. 5249/1 prot, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Pasi u miratua nga MFE dhe u publikua në faqen zyrtare

të AKAFPK-së, filloi procedura e monitorimit të posaçëm për ata ofrues të AFP-së të cilëve iu dha statusi i akreditimit me kusht.

Në bazë të raportit të akreditimit dhe propozimit të AKAFPK-së, Ministria e Financave dhe Ekonomisë mori vendimet për akreditimin me kusht për ofruesit publik të AFP-së. Procesi i Monitorimit të Posaçëm bazohet në pikën d) të nenit 24 të Urdhrit nr. 128, datë 06.07.2021 “*Për miratimin e rregullores për standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit Profesional*” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Ofruesit e AFP-së të cilët kaluan në proces monitorimi të posaçëm janë si më poshtë:

1. Shkolla e Mesme Profesionale Kamëz ⇒ 4 kualifikime profesionale sipas KSHK-së.
2. Shkolla e Mesme Teknologjike “Hysen Çela”, Durrës ⇒ 11 kualifikime profesionale sipas KSHK-së.
3. Shkolla e Mesme Teknike Elektrike “Gjergj Canco”, Tiranë ⇒ 13 kualifikime profesionale sipas KSHK-së.
4. Shkolla e Mesme Profesionale “Beqir Çela”, Durrës ⇒ 14 kualifikime profesionale sipas KSHK-së.
5. Shkolla e Mesme Teknike Ekonomike, Tiranë ⇒ 10 kualifikime profesionale sipas KSHK-së.

AKAFPK-ja pasi zhvilloi të gjithë procedurën e Monitorimit të Posaçëm, në Ofruesit publik të AFP-së, arriti në përfundimin që të propozojë, dhënien e akreditimit të plotë dhe pajisjen me certifikatën e akreditimit për këta ofrues.

Gjatë këtij viti u zhvillua dhe një procedurë e Monitorimit Individual për verifikimin e përmbushjes së rekomandimeve të lëna nga GVJ në raportin e akreditimit për ofruesin jo publik të AFP-së, Qendra Multifunksionale “Neë Generation” Tiranë.

III.III.III Veprimtari në kuadër të bashkëpunimeve

a) Në kuadër të bashkëpunimit me MFE, janë kryer këto veprimtari:

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Politikave të Punësimit dhe Aftësisimit Profesional, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është dhënë kontribut për funksionimin e SMIP dhe pasurimin e kësaj platforme me të gjithë skeletkurrikulat kombëtare.

b) Veprimtari në kuadër të projektit të Kulturë-Kontakt:

- Pjesëmarrje dhe moderim në takime me fokus përgatitjen e programit të trajnimit për “*Koordinatorët e Sigurimit të Cilësisë (përgjegjësit e Njësive të Zhvillimit) të IoAFP-ve publike*”.
- Kontribut në zhvillimin e mëtejshëm të instrumentit për “*Përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë*” si dhe përdorimi i rezultateve nga identifikimi i problemeve.
- Kontribut në zhvillimin e mëtejshëm të rishikimit për aspektet “*Gender*” në procesin e vetëvlerësimit.

- Pjesëmarrje dhe moderim në takimin e organizuar me IoAFP-të e përfshira në procesin e optimizimit, për të analizuar proceset dhe vështirësitë që patën në këtë vit të ri shkollor, lidhur me proceset e sigurimit të cilësisë.

c) Përgatitja e termave të referencës për bashkëpunëtorët e jashtëm:

- Ndjekja e procedurave për njoftimet për bashkëpunëtorë, për ngritjen e grupeve të vlerësuesve të jashtëm, në kuadër të procesit të akreditimit të IoAFP-ve.
- Përgatitja e kontratave të shërbimit për bashkëpunëtorët e Sektorit të akreditimit të ofruesve të IoAFP-ve që shpallen fitues.
- Përgatitja e urdhër - pagesave dhe ndjekja e procedurave për pagesën e bashkëpunëtorëve.
- Informimi i grupeve të interesit nëpërmjet rrjeteve dhe mediave sociale për veprimtaritë dhe aktivitetet e sektorit të akreditimit.

III.III.IV Të tjera

Sektori është angazhuar edhe në disa veprimtari të tjera që lidhen ose jo drejtpërdrejtë me përshkrimin e punës së tij:

- Përcaktimi i objektivave të vitit.
- Hartimi i planeve mujore të detajuara dhe raportimi i tyre.
- Hartimi i planit vjetor dhe raportimi i tij.
- Pjesëmarrje në komisione apo takime të ndryshme.

III.IV SEKTORI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE PROJEKTEVE

AKAFPK është krijuar si institucion në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 155, datë 24.11.2020 “Për miratimin e strukturës së Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve”, i ndryshuar me urdhrin nr. 157, datë 05.10.2023. Në zbatim dokumentit zyrtar të Departamentit të Administratës Publike me nr. prot. 6114/1, datë 15.12.2023, me lëndë “*Mbi transferimin e përhershëm të nëpunësve në kuadër të ristrukturimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve*”, AKAFPK u riorganizua.

Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Projekteve mbulon detyra mbështetëse në administrimin e burimeve njerëzore dhe financiare, zbatimin e normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor, mirë administrimin dhe mirëmbajtjen e aseteve të institucionit, çështjet juridike, sistemin kompjuterik, teknologjinë e informacionit, si dhe aplikimin e pjesëmarrjen në zbatimin e projekteve.

Zbatimi i ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar për shërbimin civil ka vazhduar të jetë në qendër të vëmendjes së AKAFPK-së. Departamenti i Administratës Publike (DAP), si institucioni publik qendror, përgjegjës për menaxhimin, mbikëqyrjen e shërbimit civil në të gjitha institucionet e administratës qendrore ka bashkëpunuar me AKAFPK në procesin e plotësimit të vendeve vakante. Gjatë vitit 2023 janë plotësuar tre vende vakante , dy nga konkurimet e DAP-it dhe një me transferim të përhershëm. Konkretisht janë plotësuar këto pozicione: Specialist në Sektorin e

Hartimit të Kurrikulave dhe Materialeve Mbështetëse, Specialist në Sektorin e Zhvillimit të Vazhduar Profesional të Mësuesve në AFP, Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të Kurrikulave dhe Materialeve Mbështetëse (transferim). Janë krijuar dy vakanca të reja pozicioni i Përgjegjës të Sektorit të Kualifikimeve për shkak të daljes në pension dhe specialisti i Sektorit të Akreditimit për shkak të pezullimit me kërkesë të tij. Gjithashtu, gjatë këtij viti kanë marrë statusin e nëpunësit civil katër prej punonjësve, në përputhje me udhëzimet periodike të DAP-it.

Njësia e Burimeve Njerëzore ishte pjesë e auditimit të brendshëm ku në përfundim të auditimit janë lënë dy rekomandime që janë: plotësimi i vendeve vakante pas përfundimit të ristrukturimit dhe hartimi i listë prezencës nga Burimet Njerëzore, detyra që kanë filluar të zbatohen menjëherë. Gjithashtu, gjatë vitit 2023, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve ka kaluar në proces ristrukturimi, për shkak të përcaktimit të klasave të reja të pagave të nëpunësve, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

AKAFPK përfaqësohet nga faqja elektronike zyrtare me adresë: ëëë.akafp.gov.al. Kjo faqe është aktive dhe përditësohet me veprimtari e njoftime të ndryshimit për t'i ardhur në ndihmë bashkëpunëtorëve shqiptarë apo të huaj, të interesuar në realizimin e produkteve në fushën e AFP-së. Në rritje të transparencës, është publikuar, gjithashtu, mënyra e funksionimit të institucionit, mënyra e financimit të tij, e organizimit, struktura, adresa e institucionit, numrat e kontaktit, si dhe adresa elektronike. Në kuadër të përmirësimit të komunikimit të brendshëm, AKAFPK nëpërmjet grupit të punonjësve të saj në platformën elektronike “Ëhatsapp”, ka shkëmbyer informacione në shërbim të objektivave institucionale. Gjithashtu, në faqen elektronike pasqyrohen veprimtaritë e projekteve të AKAFPK-së në kuadër të Programit “ERASMUS + (ERASMUS-EDU-2021-AL-AGENDA-IBA, ERASMUS-EDU-2022-EPALE-IBA dhe ERASMUS-EDU-2022-CB-VET). Sektori, veç rolit kryesor në përditësimin e ëeb-it të AKAFPK-së, ka administruar dhe mirëmbajtur rrjetin kompjuterik të institucionit.

Në mbështetje të pikës e) të nenit 24 dhe pikës a) të nenit 43, të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” janë dorëzuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, dokumentet arkivorë me afat ruajtje përgjithmonë (RHK) të viteve 2009, 2010, 2011 dhe 2012, të AKAFPK-së, që kalojnë për ruajtje dhe administrim në Arkivin Qendror Shtetëror. Komisioni i ekspertizës së vlerës së ruajtjes së dokumenteve në AKAFPK pasi shqyrtoi dokumentet me afat ruajtje të përkohshme dhe mori vendimin për asgjësim, ka kërkuar pranë DPA asgjësimin e fondit arkivor të përkohshëm të viteve 2007 - 2010, për të cilin pritet vendimi i komisionit epror të ekspertizës pranë këtij institucioni. Janë protokolluar dokumentet e vitit 2023, si edhe janë realizuar regjistrimet elektronike të tyre në funksion të mirë menaxhimit të dokumentit zyrtar të AKAFPK-së.

Gjatë 2023, nga specialisti juridik është realizuar shpërndarja për zbatim e kuadrit ligjor rregullator dhe akteve normative që i përkasin fushës së përgjegjësisë së institucionit si:

- Rregullorja nr. 24/1, datë 17.02.2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve”, e miratuar nga ministri i Financave dhe Ekonomisë.

- Rregullorja nr. 160, datë 10.07.2023 “Për funksionimin e Komitetit Sektorial”, e miratuar nga ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe ministri i Arsimit dhe Sportit.

Gjithashtu, është dhënë mendim dhe janë propozuar çështje të caktuara që lidhen me veprimtarinë e institucionit, për përmirësimin e procedurave, si dhe është kryer vlerësimi i bazueshmërinë ligjore të dokumenteve dhe praktikave shkresore për nevojat e institucionit.

Me qëllim zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, si dhe duke synuar zbatimin e së drejtës për informim si një e drejtë kushtetuese, koordinatori për të drejtën për informim (specialisti juridik) ka përditësuar programin e transparencës me të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshme për tu bërë publike. Programi i transparencës përcakton kornizën e veprimtarisë së AKAFPK dhe është i pasqyruar në faqen zyrtare elektronike të AKAFPK-së (<http://ëëë.akafp.gov.al/rreth-nesh/programi>).

Në zbatim të pikës 3 të nenit 42 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar dhe pikës 7 të Udhëzimit nr. 1, datë 27.06.2014 “Për krijimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e strukturave të autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave, në institucionet publike”, Autoriteti Përgjegjës Teknik i AKAFPK-së (specialisti juridik) ka dorëzuar raportin periodik vjetor pranë ILDKPKI-së për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike, ka raportuar periodikisht pranë ILDKPKI dhe ka dorëzuar për titullarin e AKAFPK-së formularët e plotësuar të deklaratimit të interesave private të tyre.

AKAFPK-ja është njësi koordinuese dhe përgjegjëse për zbatimin e Platformës Evropiane për Arsimin e të Rriturve (EPALE). Në kuadër të kësaj platforme AKAFPK ka zbatuar projektin EPALÉ NSS 2022-24. Në këtë projekt, sektori ka dhënë kontributin e anëtarëve të tij në zbatim të objektivave të projektit dhe në përputhje me marrëveshjen e tij. Po kështu, sektori ka dhënë kontribut në dy projektet e tjera të AKAFPK-së si: ERASMUS-EDU-2021-AL-AGENDA-IBA dhe MoMaVET, në zbatimin e aktivitete të këtyre projekteve, si dhe në korrespondencat zyrtare midis Institucionit dhe MFE. Gjithashtu, AKAFPK-ja ka aplikuar në portalin e BE për projekte të reja dhe aktualisht ka fituar projektin ERASMUS-EDU-2023-AL-AGENDA-IBA.

Për vitin buxhetor 2023, AKAFPK filloi aktivitetet e saj në janar 2023 me një buxhet të përgjithshëm prej **73,443,000 lekë**, të ndryshuar më pas në **75,635,793 lekë** të miratuar nga MFE për artikullin 600, 601, 602 dhe 606. AKAFPK për vitin 2023 ka realizuar aktivitetet e planifikuara sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela përmbledhëse e shpenzimeve të buxhetit të miratuar nga MFE dhe realizuar nga AKAFPK sipas planit për vitin 2023

KODI I PROJEKTIT	Artikulli	Plani i çelur	Plani i ndryshuar	Fakti
91011AD	600	12,007,000	13,099,244	11,720,470
91011AE	600	8,660,000	8,751,465	6,545,587

91011AF	600	6,067,000	5,352,484	4,304,855
91011AI	600	4,575,000	5,568,190	3,339,860
	SHUMA	31,309,000	32,771,383	25,910,772
91011AD	601	2,010,000	2,010,000	1,563,651
91011AE	601	1,446,000	1,931,089	1,461,155
91011AF	601	1,013,000	1,117,521	863,569
91011AI	601	765,000	800,000	405,977
	SHUMA	5,234,000	5,858,610	4,294,352
91011AD	602	13,000,000	13,000,000	9,771,966
91011AE	602	12,400,000	12,400,000	7,288,474
91011AF	602	6,600,000	6,600,000	647,366
91011AI	602	4,900,000	4,900,000	1,680,842
	SHUMA	36,900,000	36,900,000	19,388,648
91011AD	606		105800	101400
BUXHETI GJITHSEJ	SHUMA	73,443,000	75,635,793	49,695,172

Grafiku i shpenzimeve të buxhetit të miratuar nga MFE dhe realizuar nga AKAFPK sipas planit për vitin 2023




Tabela përmbledhëse e shpenzimeve të buxhetit të projektit “EPALE National Support Services (NSS) for Albania” EPALE NSS 2022-24 në llogaritë Lek dhe Euro

Llogaritë e Projektit	Buxheti i çelur në janar 2023	Çelur gjatë vitit 2023	Buxheti gjithsej	Buxheti i realizuar 2023	Buxheti i mbetur
-----------------------	-------------------------------	------------------------	------------------	--------------------------	------------------

Llogaria në Lek	1,826,650	1,022,600	2,849,250	1,908,616	940,634
Llogaria në Euro	6,998.20		6,998.20	10	6,988.20

Tabela përmbledhëse e shpenzimeve të buxhetit të projektit ERASMUS-EDU-2021-AL-AGENDA-IBA në llogaritë Lek dhe Euro

Llogaritë e Projektit	Buxheti i çelur në janar 2023	Buxheti i çelur gjatë vitit 2023	Buxheti gjithsej	Buxheti i realizuar 2023	Buxheti i mbetur
Llogaria në Lek	945,880.98	1,020,400.00	1,966,280.98	1,883,759.00	82,521.98
Llogaria në Euro	2.50			0	0

Tabela përmbledhëse e shpenzimeve të buxhetit të projektit MOMAVET 7955/1 në llogaritë Lek

Llogaritë e Projektit	Buxheti i çelur në janar 2023	Çelur gjatë vitit 2023	Buxheti gjithsej	Buxheti i realizuar 2023	Buxheti i mbetur
Llogaria në Lek	0	2,159,400.000	2,159,400	1,856,440	302,959.99

Spektori ka bashkëpunuar me sektorët e AKAFPK-së dhe MFE për hartimin e Projekteve të Buxheteve Afatmesme dhe Afatgjata (PBA) të institucionit.

Në mbështetje të ligjit nr. 9936 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e Programit Buxhetor 2024 - 2026” sektorët e AKAFPK kanë bashkëpunuar në përgatitjen e tij.

ANEKS

Aneks 1: Produkte që lidhen me profesionet

a) Përshatje të përshkrimeve të profesioneve për Programe të Kurseve të Unifikuara:

- 1 “Instalim i paneleve diellore fotovoltaike”
- 2 “Berber”
- 3 “Reception”
- 4 “Pasticier”
- 5 “Instalime dhe mirëmbajtje hidraulike”
- 6 “Instalim dhe mirëmbajtje të sistemeve ngrohje-ftohje”
- 7 “Instalim dhe mirëmbajtje të rrjetit elektrik”
- 8 “Kuzhinë”
- 9 “Parukeri”
- 10 “Zhvillim front end”
- 11 “Hedhje të dhënash”

b) Standarde Profesioni:

1. 3119.15 “Teknik i mesëm ndërtimi”
2. 6223 “Punonjës peshkimi në thellësi (det të hapur)”
3. 3121 “Përgjegjës në minierë”
4. 4311 “Llogaritar”
5. 5221.07 “Tregtar”
6. 7231.25 “Punonjës specialist për shërbime karrocierie”
7. 3115 “Teknik i lartë për automjete”
8. 5120 “Kuzhinier”
9. 7231 “Teknik të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve”
10. 751 “Teknik të teknologjisë ushqimore”
11. 3321 “Përfaqësues sigurimesh”
12. 4224 “Nëpunës në agjencitë e turistike”
13. 8113 “Punëtorë të shpimeve dhe të tjerë që lidhen me to”
14. 6111 “Menaxher dhe mbikëqyrës i prodhimeve bujqësore”
15. 7531 “Rrobaqepës”
16. 7414 “Riparues i pajisjeve elektroshtëpiake”
17. 3143.03 “Teknik silvikulturë”
18. 7223 “Punëtor i makinerive metal punuese”
19. 7233 “Riparues i makinerive”
20. 7522 “Përgjegjës prodhimi për përpunimin e drurit”
21. 7532 “Modelist”
22. “Specialist i sigurisë kibernetike”

c) Validimi i standardeve të profesioneve:

- 1) 3112.09 “Teknik hidraulik”
- 2) 3115 “Teknik i lartë për automjete”
- 3) 3119.15 “Teknik i mesëm ndërtimi”
- 4) 3121 “Përgjegjës në minierë”
- 5) 3321 “Përfaqësues sigurimesh”
- 6) 4311 “Llogaritar”
- 7) 5120 “Kuzhinier”
- 8) 5221.07 “Tregtar “
- 9) 53 “Punonjës ndihmës në shërbimet sociale dhe shëndetësore”
- 10) 6111 “Menaxherë dhe mbikëqyrës të prodhimeve bujqësore”
- 11) 6130 “Teknik i mesëm në bujqësi”
- 12) 6223 “Punonjës peshkimi në thellësi (det të hapur)”
- 13) 7119.15 “Punonjës për punime dhe riparime rrugësh”
- 14) 7214 “Përgatitës të konstruksioneve metalike dhe të ngjashëm”
- 15) 7223 “Punëtor i makinerive metal punuese”
- 16) 7231 “Teknik të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve”
- 17) 7231.25 “Punonjës specialist për shërbime karrocerie”
- 18) 751 “Teknik të teknologjisë ushqimore”
- 19) 7515 “Prodhues të produkteve dhe nënprodukteve të qumështit”
- 20) 7521 “Punonjës për prodhim materialesh me bazë druri”
- 21) 753 “Punonjës të tekstileve, të lëkurës, veshjeve dhe të ngjashme me to”
- 22) 7531 “Rrobaqepës”
- 23) 8113 “Punëtorë të shpimeve dhe të tjerë që lidhen me to”
- 24) 8160 “Prodhues të pijeve alkoolike dhe joalkoolike”

Aneks 2: Produkte që lidhen me Kualifikimeve Profesionale

a) Standarde të Kualifikimeve Profesionale

1. A2-III-23 Teknologji e prodhimit të pijeve
2. A-IV-23 Teknologji ushqimore
3. B-IV-23 Ndërtim
4. C2- III-23 Prodhime druri gjysmë të gatshme
5. D1-III-23 Rrobaqepësi
6. F1-III-23 Makina metalpunuese
7. F2-III-23 Konstruksione metalike
8. H1-V-23 Menaxhimi i cilësisë në prodhimin bujqësor
9. I-IV-23 Gjeologji - Miniera
10. J-IV-23 Detari
11. L2-IV-23 Sigurime
12. L4-IV-23 Llogari
13. L5-IV-23 Sipërmarrje e agjencisë turistike
14. L6-IV-23 Tregti
15. M4-III-23 Shërbime karrocerie
16. M-IV-23 Shërbime mjetesh transporti
17. M1-V-23 Diagnostikim - menaxhim në autoservis
18. V-IV-23 Termohidraulikë
19. X1-III-23 Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit
20. E3-III-23 Riparime të pajisjeve elektroshtëpiake

b) Validimi i standardeve të kualifikimeve:

1. A2-III-23 Teknologji e prodhimit të pijeve
2. A3-III-22 Teknologji e përpunimit të qumështit
3. A-IV-23 Teknologji ushqimore
4. B4-III-22 Punime dhe riparim rrugësh
5. B-IV-23 Ndërtim
6. C2- III-23 Prodhime druri gjysmë të gatshme
7. D-II-22 Tekstil - Konfeksione
8. D1-III-23 Rrobaqepësi
9. F1-III-23 Makina metalpunuese
10. F2-III-23 Konstruksione metalike
11. G2-III-22 Kuzhinë - Pasticëri
12. H1-V-23 Menaxhimi i cilësisë në prodhimin bujqësor
13. I-IV-23 Gjeologji - Miniera
14. J-IV-23 Detari
15. L2-IV-23 Sigurime
16. L4-IV-23 Llogari

17. L5-IV-23 Sipërmarrje e Agjencisë Turistike
18. L6-IV-23 Tregti
19. M4-III-23 Shërbime karrocierie
20. M-IV-23 Shërbime mjetesh transporti
21. M1-V-23 Diagnostikim - menaxhim në autoservis
22. O-II-22 Shërbime Sociale dhe Shëndetësore
23. V-IV-23 Termohidraulikë
24. X1-III-23 Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit

Aneks 3: Produkte që lidhen me programet orientuese

a) *Programe Orientuese për nivelet e kualifikimeve 2 - 5:*

1. Hoteleri - Turizëm, niveli II në KSHK
2. Bar - Restorant, niveli III në KSHK
3. Receptionsion, niveli III në KSHK
4. Receptionsion - pilot, niveli III në KSHK
5. Guidë turistike, niveli III në KSHK
6. Shërbime në hotel dhe restorant, niveli III në KSHK
7. Ndërtim, niveli II në KSHK
8. Muratim dhe Suvatim, niveli III në KSHK
9. Shtrim pllakash dhe veshje muresh, niveli III në KSHK
10. Punime dekorative dhe bojatisje, niveli III në KSHK
11. Instalime hidraulik, niveli III në KSHK
12. Instalime të sistemeve ngrohëse - ftohëse, niveli III në KSHK
13. Gjeologji - Miniera, niveli II në KSHK
14. Miniera, niveli III në KSHK
15. Shërbime motori, niveli III në KSHK
16. Shërbime xhenerike, niveli III në KSHK
17. Shërbime elektro - auto, niveli III në KSHK
18. Teknologji ushqimore, niveli II në KSHK
19. Përpunim druri, niveli II në KSHK
20. Ekonomi - Biznes, niveli II në KSHK
21. Detari, niveli II në KSHK
22. Detari, niveli IV në KSHK
23. Ndërtim, niveli IV në KSHK
24. Shërbime mjetesh transporti, niveli IV në KSHK
25. Shërbime mekatronike në automjete, niveli IV në KSHK
26. Termohidraulikë, niveli IV në KSHK
27. Shërbime udhëtimi dhe turizmi, niveli IV në KSHK

b) *Programe orientuese të provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale:*

1. Detari, niveli IV në KSHK
2. Ndërtim, niveli IV në KSHK
3. Shërbime mjetesh transporti, niveli IV në KSHK
4. Shërbime udhëtimi dhe turizmi, niveli IV në KSHK
5. Shërbime mekatronike në automjete, niveli IV në KSHK
6. Termohidraulikë, niveli IV në KSHK

Aneks 4: Skeletkurrikulat e AP-së

a) Skeletkurrikula të reja të Arsimit Profesional (3 skeletkurrikula):

1. Skeletkurrikuli i ri i drejtimit mësimor “Termohidraulikë”, niveli IV i KSHK (1 vjeçar)
2. Skeletkurrikulit i ri i drejtimit mësimor “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK (4 vjeçar)
3. Skeletkurrikulit i ri i profilit mësimor “Menaxhimi i cilësisë në prodhimin bujqësor”, niveli V i KSHK (1 vjeçar)

b) Skeletkurrikula të rishikuara të Arsimit Profesional (23 skeletkurrikula):

1. Skeletkurrikuli i drejtimit mësimor “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK (1 vjeçar)
2. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit”, niveli III i KSHK (1 vjeçar)
3. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Instalime elektrike civile dhe industriale”, niveli III i KSHK (1 vjeçar)
4. Skeletkurrikuli i drejtimit mësimor “Teknologji ushqimore”, niveli IV i KSHK (1 vjeçar)
5. Skeletkurrikuli i drejtimit mësimor “Gjeologji - miniera”, niveli IV i KSHK (1 vjeçar)
6. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Konstruksione metalike”, niveli III i KSHK (1 vjeçar)
7. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Sigurime”, niveli IV i KSHK (2 vjeçar)
8. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Sipërmarrje e agjencisë turistike”, niveli IV i KSHK (2 vjeçar)
9. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Administrim zyre”, niveli IV i KSHK (2 vjeçar)
10. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Tregti”, niveli IV i KSHK (2 vjeçar)
11. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Llogari”, niveli IV i KSHK (2 vjeçar)
12. Skeletkurrikuli i drejtimit mësimor “Shërbime mjetesesh transporti”, niveli IV i KSHK (1 vjeçar)
13. Skeletkurrikuli i drejtimit mësimor “Detari”, niveli IV i KSHK (1 vjeçar)
14. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Diagnostikim - menaxhim në autoservis”, niveli V i KSHK (1 vjeçar)
15. Skeletkurrikuli i drejtimit mësimor “Ndërtim”, niveli IV i KSHK (1 vjeçar)
16. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli III i KSHK (1 vjeçar)
17. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Teknologji e prodhimit të pijeve”, niveli III i KSHK (1 vjeçar)
18. Skeletkurrikuli i drejtimit mësimor “Shërbime karrocierie në automjete”, Niv. III i KSHK (1 vjeçar)
19. Skeletkurrikuli i drejtimit mësimor “Tekstil - konfeksione”, niveli II i KSHK
20. Skeletkurrikuli i drejtimit mësimor “Mekanikë”, niveli II i KSHK
21. Skeletkurrikuli i drejtimit mësimor “Pyje”, niveli II i KSHK
22. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i KSHK
23. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Kuzhinë - pastiçeri”, niveli III i KSHK

Aneks 5: Programe Kursesh të Unifikuara

a) Programe të reja të Kurseve të Unifikuara të Formimit Profesional (6 programe):

1. Programi i ri i kursit “Instalim i paneleve diellore fotovoltaike”
2. Programi i ri i kursit “Berber”
3. Programi i ri i kursit “Reception”
4. Programi i ri i kursit “Pastiçier”
5. Programi i ri i kursit “Zhvillim front end”
6. Programi i ri i kursit “Hedhje të dhënash”

b) Programe të rishikuara të Kurseve të Unifikuara të Formimit Profesional (5 programe):

1. Programi i kursit “Instalime dhe mirëmbajtje hidraulike”
2. Programi i kursit “Instalim dhe mirëmbajtje të sistemeve ngrohje - ftohje”
3. Programi i kursit “Instalim dhe mirëmbajtje të rrjetit elektrik”
4. Programi i kursit “Kuzhinë”
5. Programi i kursit “Parukeri”

Aneks 6: Materiale mësimore dhe udhëzues

a) Materiale mësimore për lëndët profesionale (20 materiale mësimore):

1. “Anatomi dhe fiziologji”, klasa 11 (72 orë), në drejtimin “Veterinari”
2. “Diagnostikimi kompjuterik i parregullsive të automjetit”, (45 orë), në profilin “Diagnostikim - menaxhim në autoservis” (pas të mesmes)
3. “Diagnostikimi i sistemeve të automjeteve elektrike dhe hibride” (120 orë), në profilin “Diagnostikim -menaxhim në autoservis” (pas të mesmes)
4. “Udhëtimi dhe turizmi”, klasa 13 (96 orë), në profilin “Sipërmarrje e agjencisë turistike”
5. “Teknikë e punimeve dekorative”, klasa 12 (68 orë), në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”
6. “Teknologji tekstili”, viti I (90 orë mësimore) në profilin “Dizenjim mode” (pas të mesmes)
7. “Menaxhimi në biznesin e modës”, viti II (42 orë mësimore) në profilin “Dizenjim mode” (pas të mesmes)
8. “Aftësitë sipërmarrëse të ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”, viti I (100 orë mësimore) në profilin “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme” (pas të mesmes)
9. “Etika profesionale dhe komunikimi”, viti I (100 orë mësimore) në profilin “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme” (pas të mesmes)
10. “Teknikë instalimi e sistemeve hidraulike”, klasa 13 (64 orë), në drejtimin “Termohidraulikë”
11. “Instalime në rrjetin e jashtëm të ujësjellësit”, klasa 12 (102 orë), në profilin “Shërbime hidraulike në ujësjellës kanalizime”
12. “Bazat e ndërhyrjes sociale”, klasa 11 (68 orë), në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”
13. “Bazat e fiziologjisë së njeriut”, klasa 11 (68 orë), në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”
14. “Bazat e prerjes”, klasa 11 (102 orë), në drejtimin “Tekstil konfeksion”
15. “Gjeodezi dhe planifikim territori”, klasa 12 (36 orë) dhe klasa 13 (32 orë) në profilin “Silvikulturë”
16. “Gjeodezi dhe planifikim territori”, klasa 13 (32 orë) në profilin “Silvikulturë”
17. “Veglat dhe makinat e përpunimit të drurit”, klasa 11 (68 orë), në drejtimin “Përpunim druri”
18. “Anatomi dhe fiziologji”, klasa 10 (108 orë), në drejtimin “Veterinari”
19. “Instalime sistemesh ngrohëse - ftohëse”, klasa 12 (102 orë), në profilin “Instalime të sistemeve ngrohëse -ftohëse”.
20. “Automjetet elektrike dhe hibride”, klasa 13 (64 orë), në profilin “Shërbime mekatronike në automjete“.

b) Udhëzues:

1. Udhëzues për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale, në kuadrin e fillimit të vitit shkollor 2023 - 2024 (në bashkëpunim)

2. Udhëzues për ndryshimet në skeletkurrikulat e kualifikimeve profesionale në vitin shkollor 2023 - 2024
3. Draft Udhëzues për trajnimet e akredituara për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP.